

KËRKESË
Nr. 4048, datë 29.7.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ura e Matit, Burrel”.

Subjekti kërkues, i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit: arë, truall dhe

objekte.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 2 084 835 (dy milionë e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë.

Për sa më sipër, dhe në zbatim të pikës 3 të vendimit nr. 336, datë 16.5.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të botimit të njoftimeve publike, për efekt të zbatimit të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, lutemi konfirmimin tuaj për publikim e kësaj kërkeje për shpronësim, sipas tekstit të mësipërm dhe listës bashkëlidhur, me qëllim autorizimin nga ana jonë sipas pikës 3 të këtij vendimi.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË OBJEKTIN "NDËRTIM URA F.MATTI, BURREL

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastr.	Numri Pasurisë	Sip. Totale	TOKË ARË			TOKË TRUALL			OBJEKTE	Vlera TOTALE (LEKË)	Shënime
							Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera lekë	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera lekë	Lloji	Vlera lekë	
	FSHATI FSHAT-BURREL Z.K. 1325														
1	Islam	Rrahman	Hysa	1325	479	5200				670	150	100500	Ndërtesë	1,840,515	Konfirmim ZVRPP
	FSHATI ZALL-SHIOSHAJ Z.K. 3882														
2	Zylyftar	Ismail	Lezaj	3882	466/17	500	163	153	24939					24939	Konfirmim ZVRPP
3	Zylyftar	Ismail	Lezaj	3882	466/18	2430	657	153	100521					100521	Konfirmim ZVRPP
4	Kaplan	Ramadan	Lezaj	3882	466/14	1200	120	153	18360					18360	Konfirmim ZVRPP
	SHUMA						940		143820	670		100500		1840515	2,084,835

